

# NENI 3

## PËRKUFIZIME

### SHTUAR

---

**PIKA 14/1.** “MATJA E AUDIENCËS” SË NJË PROGRAMI AUDIO OSE AUDIOVIZIV ËSHTË NË VARËSI TË METODËS SË MATJES – PËRCAKTIMI I PËRQINDJES SË FAMILJEVE OSE INDIVIDËVE, QË NDJEKIN NJË PROGRAM NË NJË KOHË TË CAKTUAR, NË RAPORT ME NUMRIN E PËRGJITHSHËM TË FAMILJEVE OSE INDIVIDËVE QË KANË AKSES NË NJË APARAT AUDIO/AUDIOVIZIV PAVARËSISHT NËSE AI ËSHTË I NDEZUR APO JO.

**PIKA 17/2.** “OFRUES I SHËRBIMIT TË INTERNETIT ISP” (INTERNET SERVICE PROVIDER) ËSHTË PERSONI FIZIK OSE JURIDIK I CILI OFRON AKSES NË INTERNET.

**PIKA 20/1.** “OFRUES SHËRBIMI TË MBËSHTETUR NË NJË RRJET NUMERIK KOMBËTAR” ËSHTË PERSONI JURIDIK I CILI OFRON SHËRBIMIN AUDIOVIZIV NË PËRPUTHJE ME KËRKESËN PËR MBËSHTETJE NË RRJET (OSHMA – I MBËSHTETUR).

# NENI 3

## PËRKUFIZIME

### SHTUAR

---

**PIKA 20/2.** "PLATFORMË NUMERIKE KOMBËTARE" ËSHTË TËRËSIA E MJETEVE TEKNIKE NUMERIKE PËR MBËSHTETJEN E SHËRBIMEVE TË PROGRAMEVE AUDIOVIZIVE.

**PIKA 25/1.** "PIRATERI AUDIO/AUDIOVIZIVE" ËSHTË TRANSMETIMI OSE SHPËRNDARJA QË KRYEN ÇDO SUBJEKT/PERSON FIZIK APO JURIDIK PËR PUBLIKUN ME QËLLIM SHPËRNDARJE TË KOPJEVE/PJESËVE TË NJË PROGRAMI AUDIO/AUDIOVIZIV TË MBROJTUR, PËR TË CILIN NUK GËZON TË DREJTËN E TRANSMETIMIT PAVARËSISHT MËNYRËN SI E SHPËRNDAN.

**PIKA 35/1.** "RRJET NUMERIK KOMBËTAR" ËSHTË NJË TËRËSI STACIONESH TRANSMETUES QË MBULOJNË ME SINJAL TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË.

# NENI 19

## FUNKSIONET E AMA-S

### SHTUAR

---

**PIKA 4/1. AMA NXIT PROCESIN E MATJES SË AUDIENCËS SË  
PROGRAMEVE AUDIO/AUDIOVIZIVE.**

# NENI 31

## LLOJET E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE/OSE AUDIOVIZIVE

### ISHTE

---

#### 2. OSHMA-TË MUND TË JENË:

- A) SIPAS FORMËS SË PRONËSISË MBI KAPITALIN DHE QËLLIMIN E VEPRIMTARISË, SHËRBIME PUBLIKE, PRIVATE, TREGTARE OSE JOTREGTARE;
- B) SIPAS MËNYRËS SË SHPËRNDARJES, TOKËSORE, SATELITORE, ME KABLLO, TV NË INTERNET, OSE NË NDONJË FORME TJETËR;
- C) SIPAS MBULIMIT TË TERRITORIT, KOMBËTARË, RAJONALË, LOKALË OSE NDËRKUFITARË.

### BËHET

---

#### 2. OSHMA-TË MUND TË JENË:

- A) SIPAS FORMËS SË PRONËSISË MBI KAPITALIN DHE QËLLIMIN E VEPRIMTARISË, SHËRBIME PUBLIKE, PRIVATE, TREGTARE OSE JOTREGTARE;
- B) SIPAS MËNYRËS SË SHPËRNDARJES, TOKËSORE, SATELITORE, ME KABLLO, TV NË INTERNET, OSE NË NDONJË FORMË TJETËR;
- C) *SIPAS MBËSHTETJES NË RRJETET KOMBËTARE NUMERIKE TË TRANSMETIMIT.*

## NENI 32

# RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE/OSE AUDIOVIZIVE DHE PËR OFRUESIT E PLATFORMAVE TË SHPËRNDARJES SË VIDEOVE

### ISHTE


---

5. SHËRBIMET E TRANSMETIMEVE AUDIOVIZIVE MARRIN PARASYSH NEVOJAT E PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA SHQISORE.

### BËHET

---

5. SHËRBIMET E TRANSMETIMEVE AUDIOVIZIVE MARRIN PARASYSH NEVOJAT E PERSONAVE *ME AFTËSI TË KUFIZUARA*.



# NENI 55

## LLOJET E LICENCAVE DHE AUTORIZIMEVE DHE AFATET E TYRE

### ISHTE

2. LICENCAT KATEGORIZOHEN SI MË POSHTË:
- A) LICENCAT, SIPAS PIKËS 1/A DHE 1/B, JANË KOMBËTARE, RAJONALE APO LOKALE, NË FUNKSION TË KATEGORISË SË RRJETIT TOKËSOR, NË TË CILIN MBËSHTETEN;
  - B) LICENCAT, SIPAS PIKËS 1/C DHE 1/Ç, NË FUNKSION TË KATEGORISË SË RRJETIT TOKËSOR, NDAHEN NË:
    - I) KOMBËTARE, KUR MBULOHEM ME SINJAL JO MË PAK SE 80 PËR QIND E TERRITORIT TË VENDIT;
    - II) RAJONALE, PËR MBULIM DERI NË 4 QARQE ME VAZHDIMËSI GJEOGRAFIKE;
    - III) LOKALE, PËR MBULIMIN E NJË QARKU.

### BËHET

2. LICENCAT KATEGORIZOHEN SI MË POSHTË:

- A) LICENCAT, SIPAS PIKËS 1/A JANË KOMBËTARE, RAJONALE APO LOKALE;
- B) LICENCAT, SIPAS PIKËS 1/B JANË KOMBËTARE OSE SIPAS MBËSHTETJES NË PLATFORMË NUMERIKE KOMBËTARE.

**SHTUAR** - 2.1. LICENCAT, SIPAS PIKËS 1/C DHE 1/Ç, NË FUNKSION TË KATEGORISË SË RRJETIT TOKËSOR, NDAHEN NË:

- I) KOMBËTARE, KUR MBULOHEM ME SINJAL JO MË PAK SE 80 PËR QIND E TERRITORIT TË VENDIT;
- II) SIPAS MBËSHTETJES NË PLATFORMAT NUMERIKE KOMBËTARE.

## NENI 62

# RREGULLIMI I PRONËSISË NË TRANSMETIMET AUDIO DHE AUDIOVIZIVE TOKËSORE

### ISHTE

**PIKA 6. LICENCA LOKALE APO RAJONALE E TRANSMETIMIT AUDIO DHE LICENCA LOKALE APO RAJONALE E SHËRBIMIT TË TRANSMETIMIT AUDIOVIZIV U JEPEN PERSONAVE JURIDIKË TË REGJISTRUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, ME OBJEKT EKSKLUZIV VEPRIMTARINË AUDIOVIZIVE.**

**PIKA 7. NJË PERSON FIZIK OSE JURIDIK QË KA 100 PËR QIND TË AKSIONEVE NË NJË SHOQËRI QË ZOTËRON NJË LICENCË TRANSMETIMI AUDIOVIZIV LOKALE APO RAJONALE, MUND TË MARRË VETËM NJË LICENCË TË DYTË PËR TRANSMETIM AUDIO LOKALE APO RAJONALE. NJË PERSON FIZIK OSE JURIDIK QË KA 100 PËR QIND TË AKSIONEVE NË NJË SHOQËRI QË ZOTËRON NJË LICENCË TRANSMETIMI AUDIO LOKALE APO RAJONALE, MUND TË MARRË VETËM NJË LICENCË TRANSMETIMI AUDIOVIZIVE LOKALE APO RAJONALE.**

### BËHET

**6. LICENCA LOKALE APO RAJONALE E TRANSMETIMIT AUDIO U JEPEN PERSONAVE JURIDIKË TË REGJISTRUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, ME OBJEKT EKSKLUZIV VEPRIMTARINË AUDIOVIZIVE.**

**SHTUAR - 6/1. LICENCË E TRANSMETIMIT AUDIOVIZIV PËR OFRUES TË SHËRBIMIT MEDIATIK TË MBËSHTETUR NË PLATFORMË NUMERIKE KOMBËTARE U JEPEN PERSONAVE JURIDIKË TË REGJISTRUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, ME OBJEKT EKSKLUZIV VEPRIMTARINË AUDIOVIZIVE.**

**PIKA 7. NJË PERSON FIZIK OSE JURIDIK QË KA 100 PËR QIND TË AKSIONEVE NË NJË SHOQËRI QË ZOTËRON NJË LICENCË TRANSMETIMI AUDIOVIZIV SI OFRUES I SHËRBIMIT MEDIATIK TË MBËSHTETUR, MUND TË MARRË VETËM NJË LICENCË TË DYTË PËR TRANSMETIM AUDIO LOKALE OSE RAJONALE. NJË PERSON FIZIK OSE JURIDIK QË KA 100 PËR QIND TË AKSIONEVE NË NJË SHOQËRI QË ZOTËRON NJË LICENCË TRANSMETIMI AUDIO LOKALE APO RAJONALE, MUND TË MARRË VETËM NJË LICENCË TRANSMETIMI AUDIOVIZIVE SI OFRUES I SHËRBIMIT MEDIATIK TË MBËSHTETUR.**

## NENI 62

# RREGULLIMI I PRONËSISË NË TRANSMETIMET AUDIO DHE AUDIOVIZIVE TOKËSORE

### ISHTE

---

PIKA 9. NJË PERSON FIZIK OSE JURIDIK QË KA AKSIONE NË NJË SUBJEKT QË ZOTËRON NJË LICENCË TRANSMETIMI AUDIOVIZIV LOKALE APO RAJONALE NUK MUND TË KETË MË SHUMË SE 40 PËR QIND TË KAPITALIT TË PËRGJITHSHËM NË NJË SHOQËRI TË DYTË QË ZOTËRON NJË LICENCË TRANSMETIMI AUDIOVIZIV LOKALE APO RAJONALE.

### BËHET

---

PIKA 9. NJË PERSON FIZIK OSE JURIDIK QË KA AKSIONE NË NJË SUBJEKT QË ZOTËRON NJË LICENCË TRANSMETIMI AUDIOVIZIV *SI OFRUES I SHËRBIMIT MEDIATIK TË MBËSHTETUR NË NJË PLATFORMË NUMERIKE KOMBËTARE* NUK MUND TË KETË MË SHUMË SE 40 PËR QIND TË KAPITALIT TË PËRGJITHSHËM NË NJË SHOQËRI TË DYTË QË ZOTËRON NJË LICENCË TRANSMETIMI AUDIOVIZIV *SI OFRUES I SHËRBIMIT MEDIATIK TË MBËSHTETUR NË RRJET KOMBËTAR.*



## NENI 62

# RREGULLIMI I PRONËSISË NË TRANSMETIMET AUDIO DHE AUDIOVIZIVE TOKËSORE

### ISHTE

PIKA 12. ASNJË ZOTËRUES I LICENCAVE KOMBËTARE TË TRANSMETIMEVE AUDIO DHE LICENCAVE KOMBËTARE TË TRANSMETIMIT AUDIOVIZIV, PËRFSHIRË OSHMA-TË, TË LICENCUAR PËR SHËRBIMIN E PROGRAMIT AUDIOVIZIV DHE/ OSE TË AUTORIZUAR PËR SHËRBIMIN E PROGRAMEVE TË MBËSHTETURA NË RRJETE SATELITORE, NË BAZË TË KËTIJ LIGJI, NUK MUND TË TRANSMETOJË MË SHUMË SE 30 PËR QIND TË REKLAMAVE NË TREGUN E TRANSMETIMEVE AUDIOVIZIVE. AMA MONITORON DHE PUBLIKON INFORMACION PERIODIK MBI VOLUMIN E REKLAMAVE TË TRANSMETUARA NGA OSHMA-TË KOMBËTARE.

### BËHET

PIKA 12. ASNJË ZOTËRUES I LICENCAVE KOMBËTARE TË TRANSMETIMEVE AUDIO DHE LICENCAVE KOMBËTARE TË TRANSMETIMIT AUDIOVIZIV, *PËRFSHIRË OSHMA-TË E MBËSHTETURA*, TË LICENCUAR PËR SHËRBIMIN E PROGRAMIT AUDIOVIZIV DHE/ OSE TË AUTORIZUAR PËR SHËRBIMIN E PROGRAMEVE TË MBËSHTETURA NË RRJETE SATELITORE, NË BAZË TË KËTIJ LIGJI, NUK MUND TË TRANSMETOJË MË SHUMË SE 30 PËR QIND TË REKLAMAVE NË TREGUN E TRANSMETIMEVE AUDIOVIZIVE. AMA MONITORON DHE PUBLIKON INFORMACION PERIODIK MBI VOLUMIN E REKLAMAVE TË TRANSMETUARA NGA OSHMA-TË KOMBËTARE.

# NENI 63

## SHFRYTËZIMI I MULTIPLEKSIT

### ISHTE

---

PIKA 1. MBAJTËSIT E LICENCAVE KOMBËTARE, RAJONALE E LOKALE TË TRANSMETIMEVE NUMERIKE AUDIO DHE LICENCAVE KOMBËTARE NUMERIKE TË TRANSMETIMIT AUDIOVIZIV JANË TË DETYRUAR T'U JAPIN AKSES NË KUSHTE TË DREJTA, TË ARSYESHME DHE JODISKRIMINUESE, NË JO MË PAK SE 40 PËR QIND TË KAPACITETIT TË MULTIPLEKSIT TË TYRE, OSHMA-VE QË ZOTËROJNË LICENCË SHËRBIMI PROGRAMI AUDIO DHE/OSE LICENCË SHËRBIMI PROGRAMI AUDIOVIZIV.

### BËHET

---

PIKA 1. MBAJTËSIT E LICENCAVE KOMBËTARE, RAJONALE E LOKALE TË TRANSMETIMEVE NUMERIKE AUDIO DHE LICENCAVE KOMBËTARE NUMERIKE TË TRANSMETIMIT AUDIOVIZIV JANË TË DETYRUAR T'U JAPIN AKSES NË KUSHTE TË DREJTA, TË ARSYESHME DHE JODISKRIMINUESE, NË JO MË PAK SE 40 PËR QIND TË KAPACITETIT TË MULTIPLEKSIT TË TYRE, **OSHMA-TË E MBËSHTETURA** QË ZOTËROJNË LICENCË SHËRBIMI PROGRAMI AUDIOVIZIV.

# NENI 63

## SHFRYTËZIMI I MULTIPLEKSIT

### SHTUAR

---

**PIKA 1.1. MBAJTËSIT E LICENCAVE KOMBËTARE NUMERIKE TË TRANSMETIMIT AUDIOVIZIV JANË TË DETYRUAR T'U JAPIN AKSES NË KUSHTE TË DREJTA, TË ARSYESHME DHE JODISKRIMINUESE, NË JO MË PAK SE 40 PËR QIND TË KAPACITETIT TË MULTIPLEKSIT TË TYRE, OSHMA-TË E MBËSHTETURA QË ZOTËROJNË LICENCË SHËRBIMI PROGRAMI AUDIO DHE/OSE LICENCË SHËRBIMI PROGRAMI AUDIOVIZIV.**

# NENI 63

## SHFRYTËZIMI I MULTIPLEKSIT

### ISHTE

---

PIKA 2. PAVARËSISHT PËRCAKTIMEVE TË PIKËS 1 TË KËTIJ NENI, NJË SUBJEKT I LICENCUAR PËR TRANSMETIME NUMERIKE OSE PËR OFRIMIN E SHËRBIMIT TË PROGRAMIT AUDIO OSE AUDIOVIZIV, NUK MUND TË KETË MË SHUMË SE NJË TË TRETËN E SASISË SË PËRGJITHSHME TË PROGRAMEVE PËRKATËSE LOKALE, RAJONALE DHE KOMBËTARE.

### BËHET

---

PIKA 2. PAVARËSISHT PËRCAKTIMEVE TË PIKËS 1 TË KËTIJ NENI, *NJË SUBJEKT I LICENCUAR PËR PLATFORME NUMERIKE KOMBËTARE OSE PËR OFRIMIN E SHËRBIMIT TË PROGRAMIT AUDIO OSE AUDIOVIZIV, NUK MUND TË KETË MË SHUMË SE NJË TË TRETËN E SASISË SË PËRGJITHSHME TË PROGRAMEVE PËRKATËSE.*

## NENI 69

# HEQJA E LICENCËS DHE/OSE AUTORIZIMIT

### ISHTE

PIKA 4. AMA KA TË DREJTË TË HEQË LICENCËN DHE/OSE AUTORIZIMIN KUR:...

4. NUK KA FILLUAR TRANSMETIM PAS HYRJES NË FUQI TË VENDIMIT PËR DHËNIE LICENCE PËR NJË PERIUDHË KOHE:

- A) 6 MUAJ NË TRANSMETIMET AUDIO LOKALE E RAJONALE;
- B) 9 MUAJ NË SHËRBIMIN E TRANSMETIMIT AUDIOVIZIV LOKAL E RAJONAL;
- C) 12 MUAJ NË VËNIEN NË FUNKSIONIM TË MULTIPLEKSIT LOKAL E RAJONAL;
- Ç) 12 MUAJ NË TRANSMETIMET AUDIO KOMBËTARE;
- D) 18 MUAJ NË SHËRBIMIN E TRANSMETIMEVE AUDIOVIZIVE KOMBËTARE;
- DH) 24 MUAJ NË VËNIEN NË FUNKSIONIM TË MULTIPLEKSIT KOMBËTAR.

### BËHET

AMA KA TË DREJTË TË HEQË LICENCËN DHE/OSE AUTORIZIMIN KUR:...

4. NUK KA FILLUAR TRANSMETIM PAS HYRJES NË FUQI TË VENDIMIT PËR DHËNIE LICENCE PËR NJË PERIUDHË:

- A) 6 MUAJ NË TRANSMETIMET AUDIO LOKALE DHE RAJONALE
- B) 9 MUAJ NË SHËRBIMIN E TRANSMETIMIT AUDIOVIZIV SI OSHMA- TË MBËSHTETUR,*
- C) 12 MUAJ NË VËNIEN NË FUNKSIONIM TË MULTIPLEKSIT LOKAL E RAJONAL;
- Ç) 12 MUAJ NË TRANSMETIMET AUDIO KOMBËTARE;
- D) 18 MUAJ NË SHËRBIMIN E TRANSMETIMEVE AUDIOVIZIVE KOMBËTARE;
- DH) 24 MUAJ NË VËNIEN NË FUNKSIONIM TË MULTIPLEKSIT KOMBËTAR.

## NENI 74

# AFATI I LICENCËS DHE TRANSFERIMI I TË DREJTAVE DHE DETYRIMEVE QË RRJEDHIN PREJ SAJ

### ISHTE

---

**PIKA 1. AFATI I VLEFSHMËRISË SË LICENCËS SË  
RRJETIT NUMERIK ËSHTË:**


- A) 15 VJET PËR TRANSMETIMET KOMBËTARE;**
- B) 8 VJET PËR TRANSMETIMET RAJONALE E LOKALE**

### BËHET

---

**AFATI I VLEFSHMËRISË SË LICENCËS SË RRJETIT  
NUMERIK ËSHTË:**

- A) 15 VJET PËR TRANSMETIMET KOMBËTARE;**
- B) 8 VJET PËR OSHMA-TË E MBËSHTETURA;**



# NENI 132/1 PIRATERIA

## SHTUAR

---

**PIKA 1. PRODHUESI I NJË VEPRE AUDIOVIZUALE ËSHTË PERSONI FIZIK OSE JURIDIK, I CILI ËSHTË PËRGJEGJËS PËR PRODHIMIN E VEPRËS, SI DHE SIGURON BURIMET E NEVOJSHME TEKNIKE E FINANCIARE PËR REALIZIMIN E SAJ, SIPAS KUSHTEVE TË KONTRATËS. E DREJTA E TRANSMETIMIT AUDIOVIZIV ËSHTË E DREJTA EKSKLUZIVE E PRODHUESIT APO E SUBJEKTIT QË GËZON TË DREJTËN E TRANSMETIMIT APO SHPËRNDARJES ME LEJE APO MARRËVESHJE PËR KALIM TË DREJTASH ME PRODHUESIN.**

**PIKA 2. KALIMI I SË DREJTËS, TË BËHET VETËM NË BAZË TË NJË KONTRATE ME SHKRIM, E CILA DEPOZITOHET PRANË AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE.**

**PIKA 3. SUBJEKTI/PERSONI I CILI PA LICENCË/AUTORIZIM: TRANSMETON, HEQ OSE NDRYSHON TË DHËNAT E TË DREJTAVE TË TRANSMETIMIT AUDIOVIZIV, NË FORMË ELEKTRONIKE, PRODHON, SHPËRNDAN, ME QËLLIM TË VENDOSJES NË TREG, TRANSMETON, KOMUNIKON ME PUBLIKUN OSE VË NË DISPOZICION TË PUBLIKUT VEPRA OSE OBJEKTE TË MBROJTURA NGA TË DREJTAT E TRANSMETIMIT OSE TË DREJTA TË TJERA TË LIDHURA ME TË, KRYEN SHKELJE TË KËTIJ LIGJI DHE SI I TILLË DO TË NDËSHKOHET. SUBJEKT I KËTIJ LIGJI DO TË JENË EDHE PËRFITUESIT, TË CILËT PËRFITOJNË NGA SHKELJA DHE MARRIN PROGRAME PA TË DREJTA.**

# NENI 132/1 PIRATERIA

## SHTUAR

---

**PIKA 4. SUBJEKTET E LICENCUARA NGA AKEP, SI OFRUES TË SHËRBIMIT TË INTERNETIT, QË TRANSMETOJNË VETË OSE NËPËRMJET RRJETIT TË TYRE, PROGRAME PA PATUR TË DREJTË TRANSMETIMI, PAS NJOFTIMIT NGA AMA, BRENDË 30 MINUTAVE DUHET TË NDËRPRESIN MENJËHERË TRANSMETIMIN PA TË DREJTA. NËSE SUBJEKTI NUK REAGON BRENDË KËTIJ AFATI, DO TI NËNSHTROHET PARASHIKIMEVE TË NENIT 133/5 TË KËTIJ LIGJI.**



# NENI 133 GJOBAT

## ISHTE

PIKA 5. SHKELJET E MËPOSHTME, TË KRYERA NGA I LICENCUARI OSE I AUTORIZUARI, KUR NUK PËRBËJNË VEPËR PENALE, JANË KUNDËRVAJTJE ADMINISTRATIVE DHE DËNOHEN SI MË POSHTË:.. ME GJOBË NGA 5 000 000 DERI NË 10 000 000 LEKË PËR RASTET KUR NJË PERSON INSTALON PAJISJE TELEVIZIVE OSE RADIOJE, DUKE DALË NË TRANSMETIM NË EFIR ME SINJAL AUDIO OSE AUDIOVIZIV PA AUTORIZIMIN OSE LICENCIMIN E AMA-S.

## BËHET

PIKA 5. SHKELJET E MËPOSHTME, TË KRYERA NGA I LICENCUARI OSE I AUTORIZUARI, KUR NUK PËRBËJNË VEPËR PENALE, JANË KUNDËRVAJTJE ADMINISTRATIVE DHE DËNOHEN SI MË POSHTË:.. ME GJOBË NGA 5 000 000 DERI NË 10 000 000 LEKË PËR RASTET KUR *NJË PERSON/SUBJEKT VEPRON SI OFRUES I SHËRBIMIT TË INTERNETIT "ISP" DHE TRANSMETON PA AUTORIZIMIN/LICENCIMIN E AMA-S* OSE INSTALON PAJISJE TELEVIZIVE OSE RADIOJE, DUKE DALË NË TRANSMETIM NË EFIR ME SINJAL AUDIO OSE AUDIOVIZIV PA AUTORIZIMIN OSE LICENCIMIN E AMA-S.

# NENI 133 GJOBAT

## ISHTE

PIKA 7. ME GJOBË NGA 1 000 000 DERI NË 2 000 000 LEKË KUR NUK RESPEKTON DETYRIMET E PARASHIKUARA NË NENIN 32 PIKA 6 TË KËTIJ LIGJI. PËRSËRITJA E SHKELJES MË SHUMË SE 3 HERË DËNOHET ME ULJEN DERI NË 50 PËR QIND TË AFATIT TË LICENCËS DHE/OSE AUTORIZIMIT. NË RAST RIPËRSËRITJEJE, SHKELJA NDËSHKOHET ME HEQJEN E LICENCËS DHE/OSE AUTORIZIMIT

## BËHET

7. ME GJOBË NGA 1 000 000 DERI NË 2 000 000 LEKË KUR NUK RESPEKTON DETYRIMET E PARASHIKUARA NË NENIN 32 PIKA 6 TË KËTIJ LIGJI. PËRSËRITJA E SHKELJES MË SHUMË SE 3 HERË **GJATË VLEFSHMËRISË SË LICENCËS/AUTORIZIMIT** DËNOHET ME ULJEN DERI NË 50 PËR QIND TË AFATIT TË LICENCËS DHE/OSE AUTORIZIMIT. NË RAST RIPËRSËRITJEJE, SHKELJA NDËSHKOHET ME HEQJEN E LICENCËS DHE/OSE AUTORIZIMIT.

# NENI 133 GJOBAT

## SHTUAR

---

**PIKA 10. PËRFITUESI NGA TRANSMETIMI I PA LICENCUAR SIPAS PARASHIKIMIT TË NENIT 132/1 PIKA 3, PARASHIKOHET DËNIM ME GJOBË NË MASËN 50.000 DERI 200.000 LEKË.**

**PIKA 11. ME GJOBË NGA 500.000 DERI 2 000.000 LEKË DO TË DËNOHET ÇDO SHKELJE E KËTIJ LIGJI QË NUK ËSHTË PARASHIKUAR NË PIKAT E MËSIPËRME.**

# SHFUQIZUAR

***NENI 139* - LICENCIMI I RRJETEVE NUMERIKE DHE PROGRAMEVE QË MBËSHTETEN NË TO NË PERIUDHËN TRANZITORE**

***NENI 140* - AFATI MAKSIMAL PËR LIRIMIN E FREKUENCAVE TË ZËNA ARBITRARISHT**